



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo Obrazovanja i Nauke/ Ministry of Education,
and Science*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 01-12

Datë: 18.06.2020

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në mbështetje të nenit 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare nr. 7 / 01 mars 2019), nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Rregullores (QRK) nr. 07/2020 dhe shtojcës 11 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e dt. 08.06.2020, nxjerr:

V E N D I M

Për shtyrjen e afatit të testit të arritshmërisë dhe testit të maturës shtetërore

1. Shtyhet afati i provimeve për testin e arritshmërisë dhe testi për provimin e maturës shtetërore si në vijim:

1.1. Testi i arritshmërisë mbahet me datë 20.08.2020;

1.2. Testi i provimit të maturës shtetërore mbahet me 29.08.2020.

2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Duke u bazuar në dispozitat e cekura më lartë si dhe në konsultim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, për shkak të pandemisë me virusin COVID 19 dhe për shkak të ruajtjes së shëndetit publik të fëmijëve, afati i provimeve për testin e arritshmërisë dhe testi për provimin e maturës shtetërore, shtyhet për afatet e cekura më lartë, prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Kabinetit të Ministrit/ MASH;
2. Zyrës së SP/MASH;
3. Arkivit/MASH.


Ministër/MASH

